

	NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A. JAVNO LOKALNO PREDUZEĆE AUTOBUSKA STANICA D.O. PUBLIC ENTERPRISE LOCAL BUS STATION J.S.C.		
Nr. No.	02/448	Data Datë	26.04 20 17
PRISHTINË/A			

## NPL STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A. PRISHTINË

### Raporti i Auditorit te Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për periudhën 01 Janar deri më 31 Dhjetor 2016

Prishtinë, Prill 2017

# **NPL STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A. PRISHTINË**

## **Raporti i Auditorit te Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për periudhën 01 Janar deri më 31 Dhjetor 2016**

Prishtinë, Prill 2017

## Përmbajtja

faqe

Informatat e përgjithshme .....	3
Raporti i auditorit të pamvarur.....	4
Pasqyra e Pozitës financiare .....	6
Pasqyra e të Ardhurave.....	9
Pasqyra e ndërrimeve të ekuitetit.....	11
Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme.....	12
Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin 2016 .....	14
Bazat e përgatitjes dhe Politikat e kontabilitetit.....	15

## Informata të Përgjithshme

Organet e Ngarkuara me Qeverisjen:

- z. Sherif Sejdiu, Kryetar i Bordit
- z. Flamur Zeqiri, Drejtor jo Ekzekutiv
- z. Gani Sopi, Drejtor jo Ekzekutiv,
- z. Fatmir Dervishi, Drejtor jo Ekzekutiv

Menaxhmenti:

Ylber Çitaku – Kryeshef Ekzekutiv

Nezir Rama – Zv. Kryeshef Ekzekutiv

Ahmet Maxhuni – Zv. Krfyeshef Ekzekutiv

Adresa:

Rr. "Lidhja e Pejës" p.n.  
10000 Prishtinë, Kosovë

Banka Koresponduese:

ProCredit Bankë,

NLB Prishtinë

Auditorë:

Kompania e Licencuara "H&N" Sh.p.k

Rruga Ilaz Kodra nr.29  
10000 Prishtinë, Kosovë

**Kontakti:** [auditimit@gmail.com](mailto:auditimit@gmail.com),

**Tel:** 038 / 541 144



## RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR

Për Organet e Ngarkuara me Qeverisjen dhe Drejtimin e Kompanisë NPL STACIONI I AUTOBUSËVE Sh.A. Prishtinë.

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të NPL stacioni i Autobusëve Sh.A. Prishtinë (Kompania”), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2016, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

*Sipas mendimit tonë pa bërë kualifikime, ne tërheqim vëmendjen e mëposhtme për theksimin e çështjes:*

\*\*\* Si praktikë e mirë të bëhet rivlerësimi i pasurisë sipas rregullores (KE) Nr. 1606 mbi aplikimin SNK-ëve, dhe në veçanti SNK-36, Vendimit Shpjegues Publik, MEF-ATK nr. 05/2009 (për Zhvlerësimin dhe dëmtimin e aseteve të Ndërmarrjeve me Pronësi Publike -NPP) shënimi 6., pasqyrat financiare të Kompanisë paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2016, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilitetë Profesionalistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF, dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Kompaninë apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

### Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.

- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Kompanisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.

- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në të një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet të shprehme të përbalojnë përfitimet në favor të interesit publik.

Kryerësi i shërbimeve audituese



"H&N" Sh.p.k

Rruga Ilaz Kodra nr.29

10000 Prishtinë, Kosovë

21 Prill 2016

Emri i kompanisë: NPL "Stacioni i Autobusëve" Prishtinë  
 Numri fiskal: 600118245  
 Adresa: Rruga e Leninit P.n.  
 Komuna: Prishtinë



RAPORTI FINANCIAR VJETOR PËR SHOQËRITË TREGTARE

I. BILANCI I GJENDJES

Më

datën 31.12.2016

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
			Viti vijues 16	Viti i kaluar 15
	PASURITË			
A	KAPITALI I THIRRUR I PAPAGUAR			
B	PASURITË JOQARKULLUESE (I+II+III+IV)		2,741,710.84	2,876,977.66
I	PASURITË E PAPREKSHME (1 deri 4)		0.00	0.00
1	Kostot e zhvillimit			
2	Patentat, licencat, markat tregtare, softueri dhe të drejtat tjera			
3	Emri i mirë (Goodwilli)			
4	Pasuritë tjera të paprekshme			
II	PASURITË E PREKSHME (1 deri 7)		2,741,710.84	2,876,977.66
1	Toka	6	1,158,868.60	1,158,868.60
2	Objektet ndërtimore	6	1,530,823.69	1,682,541.67
3	Pajisjet dhe makineritë			
4	Veglat, inventari i reparit dhe mjetet transportuese	6	52,018.55	35,567.39
5	Pasuritë biologjike			
6	Pasuritë tjera të prekshme			
7	Investimet në patundshmëri			
III	PASURITË FINANCIARE JOQARKULLUESE (1 deri 6)		0.00	0.00
1	Aksionet tek filialet			
2	Huatë e dhëna ndërmarrësve të ndërlidhur			
3	Investimet në ortakëri			
4	Investimet në letra me vlerë			
5	Huatë e dhëna, depozitat dhe të ngjashme			
6	Pasuritë tjera financiare joqarkulluese			
IV	PASURITË E SHTYRA TATIMORE			
C	PASURITË QARKULLUESE (I+II+III+IV)		344,682.91	373,253.04
I	STOQET (1 deri 5)		1,441.68	1,561.57
1.	Lënda e parë dhe materiali	7	1,441.68	1,561.57
2.	Prodhimtaria në vijim			
3.	Produktet e gatshme			
4.	Mallrat e listuara në bursë			
5.	Pasuritë tjera qarkulluese për shitje			
II	LLOGARITË E ARKËTUESHME (1 deri 6)		99,705.63	173,759.09
1.	Llogaritë e arkëtueshme nga filialet			
2.	Llogaritë e arkëtueshme tregtare	8	52,164.92	139,346.03
3.	Llogaritë e arkëtueshme nga filialet			
4.	Llogaritë e arkëtueshme nga punëtorët		1,518.16	2,110.34

5.	Llogaritë e arkëtueshme nga shteti dhe institucionet tjera	8	37,586.23	23,736.94
6.	Llogaritë tjera të arkëtueshme	8	8,436.32	8,565.78
<b>III</b>	<b>PASURITË FINANCIARE QARKULLUESE (1 deri 6)</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
1.	Aksionet tek filialet			
2.	Huatë e dhëna ndërmarrësve të ndërlidhur			
3.	Investimet në ortakëri			
4.	Investimet në letra me vlerë			
5.	Huatë e dhëna, depozitat dhe të ngjashme			
6.	Pasuritë tjera financiare joqarkulluese			
<b>IV</b>	<b>PARATË NË BANKË DHE ARKË</b>	<b>9</b>	<b>243,535.60</b>	<b>197,932.38</b>
<b>E</b>	<b>GJITHSEJT PASURITË (A+B+C+D+E)</b>		<b>3,086,393.75</b>	<b>3,250,230.70</b>
<b>F</b>	<b>ZËRAT JASHTËBILANCORË</b>			
	<b>EKUITETI AKSIONAR, REZERVAT DHE DETYRIMET</b>			
<b>A</b>	<b>EKUITETI AKSIONAR DHE REZERVAT (I+II+III+IV+V+VI+VII)</b>		<b>3,015,270.52</b>	<b>3,182,308.04</b>
<b>I</b>	<b>KAPITALI THEMELUES (I REGJISTRUAR )</b>		<b>5,251,141.39</b>	<b>5,251,141.39</b>
<b>II</b>	<b>KAPITALI REZERVË</b>			
<b>III</b>	<b>REZERVAT NGA FITIMI (1 deri 4)</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
1.	Rezervat ligjore			
2.	Rezerva për aksionet vetjake			
3.	Rezervat statutore			
4.	Rezervat tjera			
<b>IV</b>	<b>REZERVAT E RIVLERËSIMIT</b>			
<b>V</b>	<b>FITIMET/HUMBJET E BARTURA</b>		<b>-2,068,833.35</b>	<b>-1,946,320.75</b>
<b>VI</b>	<b>FITIMI APO HUMBJA E VITIT FINANCIAR</b>	<b>4</b>	<b>-167,037.52</b>	<b>-122,512.60</b>
<b>VII</b>	<b>INTERESI MINORITAR</b>			<b>0.00</b>
<b>B</b>	<b>DETYRIMET AFATGJATA (1 deri 8)</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
1	Obligimet ndaj filialave			
2	Obligimet për hua, depozita dhe të ngjashme			
3	Obligimet ndaj bankave dhe institucioneve tjera financiare			
4	Obligimet afatgjata për avance			
5	Llogaritë e pagueshme tregtare			
6	Obligimet për letra me vlerë			
7	Llogaritë tjera të pagueshme			
8	Detyrimet e shtyra tatimore			
<b>C</b>	<b>DETYRIMET AFATSHKURTA (1 deri 11)</b>		<b>71,123.23</b>	<b>67,922.66</b>
1	Obligimet ndaj filialave			
2	Obligimet për hua, depozita dhe të ngjashme			
3	Obligimet ndaj bankave dhe institucioneve tjera financiare			
4	Obligimet afatgjata për avance			
5	Llogaritë e pagueshme tregtare	10	41,247.30	36,606.47
6	Obligimet për letra me vlerë			
7	Llogaritë tjera të pagueshme	10	7,880.26	7,925.91
8	Obligimet ndaj të punësuarëve			
9	Obligimet për tatime dhe kontribute	10	21,995.67	23,390.28
10	Obligimet ndaj aksionarëve për dividenda			
11	Obligimet tjera afatshkurta	8	0.00	0.00

D	GJITHSEJ EKUITETI AKSIONAR, REZERVAT DHE DETYRIMET (A+B+C+D)		3,086,393.75	3,250,230.70
E	ZËRAT JASHTË BILANCIT			
	<i>Vetëm për Raportet e konsoliduara</i>			
A	EKUITETI AKSIONAR DHE REZERVAT			
1	Iu takon pronarëve të kompanisë mëmë			
2	I takon interesit minoritar			

Këto Pasqyra Financiare janë aprovuar nga Drejtimi i kompanisë me datë 31.03.2017

Emin Sylejmani

Pozita:UD I ZKFTH



Kryeshef Ekzekutiv

Ben Çitaku

Shënimet nga numri 1 deri në numrin 14 janë pjesë përbërës e këtyre Pasqyrave Financiare.

Emri i kompanisë: NPL "Stacioni i Autobusëve" Prishtinë  
 Numri fiskal: 600118245  
 Adresa: Rruga Bill Clinton P.n.  
 Komuna: Prishtinë

## II. PASQYRA E TË ARDHURAVE

Për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2016

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
			Viti vijues	Viti i kaluar
I	<b>TE HYRAT (1 deri 3)</b>			
1	Të hyrat nga shitja	4	923,543.64	863,675.73
2	Të hyrat nga përdorimi i produkteve, mallrave dhe shërbimeve			
3	Të hyrat tjera afariste		923,543.64	863,675.73
II	<b>SHPENZIMET (1 deri 7)</b>	4	1,090,581.16	986,188.31
1	Zvogëlimi i vlerës së stoqeve			
2	Rritja e vlerës së stoqeve			
3	Shpenzimet e materialit (a+b+c)		2,120.95	4,193.27
	a) Materiali dhe lënda e parë			
	b) Shpenzimet e mallit të shitur		2,120.95	4,193.27
	c) Shpenzimet tjera			
4	Shpenzimet e pagave (a+b)		700,765.69	652,695.72
	a) Pagat dhe medijtjet bruto		667,356.33	621,616.95
	b) Kontributi për sig.pens/Punëdhënës		33,409.36	31,078.77
5	Zhvlerësimi		172,711.86	171,810.42
6	Shpenzimet tjera		214,982.66	
7	Shpenzimet tjera afariste			
III	<b>TE ARDHURAT FINANCIARE (1 deri 5)</b>		0.00	157,488.90
1	Kamatat, diferencat e kursit, dividendat dhe të ardhurat e ngjashme nga filialet		0.00	0.00
2	Kamatat, diferencat e kursit, dividendat dhe të ardhurat e ngjashme nga të tjerët			
3	Pjesa e të hyrave nga filialet			
4	Fitimi i perealizuar			
5	Të ardhurat tjera financiare			
IV	<b>TË DALAT FINANCIARE (1 deri 4)</b>		0.00	0.00
1	Kamatat, diferencat e kursit, dividendat dhe të ardhurat e ngjashme nga filialet			
2	Kamatat, diferencat e kursit, dividendat dhe të ardhurat e ngjashme nga të tjerët			
3	Humbja e perealizuar			
4	Të dalat tjera financiare			
V	<b>Të ardhurat tjera të pazakonshme</b>			
VI	<b>Të dalat tjera të pazakonshme</b>			
VII	<b>GJITHSEJ TË ARDHURAT (I+III+V)</b>	4	923,543.64	863,675.73
VIII	<b>GJITHSEJ SHPENZIMET (II+IV+VI)</b>	4	1,090,581.16	986,188.31
IX	<b>FITIMI PARA TATIMIT (VII-VIII)</b>		0.00	0.00
X	<b>HUMBJA PARA TATIMIT (VIII-VII)</b>	4	167,037.52	122,512.58
XI	<b>TATIMI NË FITIM</b>			

XII	FITIMI NETO (IX-XI)		0.00	0.00
XIII	HUMBJA E PERIUdhËS (X+XI) ose (XI-IX)		167,037.52	122,512.58
	<i>Vetëm për Raportet e konsoliduara</i>			
A	FITIMI/HUMBJA E PERIUdhËS			
1	Iu takon pronarëve të kompanisë mëmë			
2	I takon interesit minoritar			

Shënimet nga numri 1 deri në numrin 14 janë pjesë përbërës e këtyre Pasqyrave Financiare.

Emri i kompanisë: NPL "Stacioni i Autobusëve" Prishtinë  
 Numri fiskal: 600118245  
 Adresa: Rruga Bill Clinton P.n.  
 Komuna: Prishtinë

IV. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

Për periudhën 01.01.016 deri 31.12.016

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
			Viti vijues	Viti i kaluar
1	Kapitali i regjistruar		5,251,141.39	5,251,141.39
2	Rezervat e kapitalit			
3	Fitimet e mbajtura ose humbjet e akumuluar		-	
4	Fitimi ose humbja nga viti vijues		1,946,320.75	-1,868,464.35
5	Rivlerësimi i pasurive joqarkulluese të prekshme		-122,512.60	-77,856.40
6	Rivlerësimi i pasurive joqarkulluese të paprekshme		0.00	0.00
7	Rivlerësimi i pasurive financiare në dispozicion për shitje			
8	Rivlerësime tjera			
<b>Gjithsej kapitali dhe rezervat (1 deri 8)</b>			<b>3,182,308.04</b>	<b>3,304,820.64</b>
9	Diferenca të kursit nga investimet neto në afarizmin në botën e jashtme			
10	Tatimet aktuale dhe të shtyra			
11	Mbrojtja e rrjedhës së parasë			
12	Ndryshimi në politikat kontabël			
13	Korrigjimi i gabimeve materiale nga periudhat paraprake			
14	Ndryshime tjera në ekuitet			
<b>Rritja apo zvogëlimi i tërësishëm në kapital (9 deri 14)</b>			<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Vetëm për Raportet e konsoliduara</b>				
a)	Iu takon pronarëve të kompanisë mëmë			
b)	I takon interesit minoritar			

Shënimet nga numri 1 deri në numrin 14 janë pjesë përbërës e këtyre Pasqyrave Financiare.

Emri i kompanisë: NSh "Stacioni i Autobusëve" Prishtinë  
 Numri fiskal: 600118245  
 Adresa: Rruga Bill Clinton P.n.  
 Komuna: Prishtinë

### III. PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

METODA DIREKTE

Për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2016

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
			Viti vijues	Viti i kaluar
<b>RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE</b>				
1	Arkëtimet e parasë nga blerësit		923,543.64	863,675.73
2	Arkëtimet e parasë nga honorarët, tarifat, komisionet e të ngjashme			
3	Arkëtimet e parasë nga sigurimi për kompensim dëmi			
4	Arkëtimet e parasë nga rimbursimi i tatimit			
5	Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet operative		74,053.46	14,306.48
I	<b>GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE (1 deri 5)</b>		<b>997,597.10</b>	<b>877,982.21</b>
1	Pagesat e parasë për furnitorët		-4,715.07	28,811.01
2	Pagesat e parasë për të punësuarit		700,765.69	652,695.72
3	Pagesat e parasë për sigurimin për kompensimin e dëmeve			
4	Pagesat e parasë për interes			
5	Pagesat e parasë për tatime		1,394.61	3,762.19
6	Pagesat e tjera të parasë për aktivitetet operative		217,103.61	161,682.20
II	<b>GJITHSEJ PAGESAT E PARASË PËR AKTIVITETET OPERATIVE (1 deri 6)</b>		<b>914,548.84</b>	<b>846,951.12</b>
A	<b>RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE (I-II)</b>		<b>83,048.26</b>	<b>31,031.09</b>
<b>RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE</b>				
1.	Arkëtimet e parasë nga shitja e pasurive joqarkulluese, të prekshme dhe të paprekshme			
2.	Arkëtimet e parasë nga shitja e pronës dhe instrumenteve të borxhit			
3.	Arkëtimet e parasë nga interesi			
4.	Arkëtimet e parasë nga dividendat			
5.	Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet investuese			
III	<b>GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE (1 deri 5)</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
1.	Pagesat e parasë për blerjen e pasurive joqarkulluese, të prekshme dhe të paprekshme		37,445.04	34,387.46
2.	Pagesat e parasë për blerjen e pronës dhe instrumenteve të borxhit			
3.	Pagesa tjera të parasë për aktivitetet investuese			
IV	<b>GJITHSEJ PAGESAT E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE (1 deri 3)</b>		<b>37,445.04</b>	<b>34,387.46</b>
B	<b>RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE (III-IV)</b>		<b>-37,445.04</b>	<b>-34,387.46</b>
<b>RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUERE</b>				
1.	Arkëtimet e parasë nga emetimi e instrumenteve financiare të borxhit dhe atyre të ekuitetit			
2.	Arkëtimet e parasë nga kryegjëja e kredisë, fletë obligacionet, huatë dhe huazimet tjera			
3.	Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet financuese		0.00	0.00
V	<b>GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUERE (1 deri 3)</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

1.	Pagesat e parasë për pagimin e kryegjësë së kredisë dhe fletëobligacioneve			
2.	Pagesat e parasë për dividenda			
3.	Pagesat e parasë për lizingun financiar			
4.	Pagesat e parasë për ri-blerjen e aksioneve vetjake të kompanisë			
5.	Pagesa tjera të parasë për aktivitetet financuese			
VI	<b>GJITHSEJ PAGESAT E PARASË PËR AKTIVITETET FINANCUERE (1 deri 5)</b>		0.00	
C	<b>RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUERE (V-VI)</b>		0.00	0.00
D	<b>RRJEDHA NETO E PARASË (A+B+C)</b>		45,603.22	-3,356.37
E	<b>PARATË DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FILLIM TË PERIUdhËS</b>		197,932.38	201,288.74
F	<b>PARATË DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FUND TE PERIUdhËS (D+E)</b>		243,535.60	197,932.37
G	<b>RRITJA (ZVOGËLIMI) I PARASË DHE EKVIVALENTËVE TË PARASË</b>		45,603.22	-3,356.37

Shënimet nga numri 1 deri në numrin 14 janë pjesë përbërës e këtyre Pasqyrave Financiare.

## Shënimet për pasqyrat financiare për vitin 2016

### 1. Informata të përgjithshme

Ndërmarrja Shoqërore Stacioni i Autobusëve, është themeluar me vendimi te Kuvendit Komunal te Prishtinës me aktin nr. 110-94/77-01, te datës 15 Nëntor 1977. Ndërsa, kjo ndërmarrje punën e ka filluar ne vitin 1983. Pas përfundimit te luftës se vitit 1999, kjo ndërmarrje është regjistruar ne baze te rregullores se UNMIK-ut 2000/6 mbi Shoqëritë Tregtare me numër te biznesit 80060165 datë:14.06.2000 dhe është administruar nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) dhe me pastaj i transformuar Agjencioni Kosovari i Privatizimit (AKP).

Në bazë ë nenit 23 të Ligjit nr. 04/L – 111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike, Stacioni i autobusëve SH.A. në Prishtinë është paraparë në Listën 2, ku janë caktuar Ndërmarrjet publike lokale në nivel të Kosovës. Mbi bazën e këtyre ligjeve, Kuvendi Komunal i Prishtinës është pronar i vetëm dhe i ligjshëm i te gjitha aksioneve te ndërmarrjes.

Duke u bazuar në paragrafin 1 të këtij neni, Stacioni i autobusëve, veprimtarinë e tij do ta ushtrojë me emërtimin: Ndërmarrja publike lokale "Stacioni i autobusëve", SH.A., Prishtinë i regjistruar me numër te ri te biznesit (NRB) 71224851 me datë 21.01.2015 dhe me numër fiskal pranë ATK-se 600118245. Emërtimin i shkurtër i ndërmarrjes së cekur në paragrafin 2 të këtij neni është: NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Prishtinë.

Kuvendi Komunal i Prishtinës ne emër te pronarit te vetëm te aksioneve e ushtron kompetencën dhe përgjegjësin e ne baze te Ligjit, Statutit dhe akteve tjera nënligjore.

Ndërmarrja është e licencuar nga Ministria e transportit dhe Postë Telekomunikacionit për ushtrimin e veprimtarisë së sajë me Licencë me nr. 031/220 të datës 13.03.2013. Licenca lëshohet për 5 (pesë) vite e cila ka karakterin e pasimit në kategorizimin e stacioneve e cila sipas licencës në fjale i ka plotësuar kushtet për kategorinë "A" nga katër kategoritë e parapara me Udhëzimin Administrativ (kat. "A", "B", "C" dhe "D" nga ma kualitative në atë më të dobët).

Ndërmarrja posedon sipërfaqe e objekte të mjaftueshme për kryerjen e veprimtarisë si vijon :

- Sipërfaqe 7 ha e 62 ari e 29 m<sup>2</sup>, (Fleta Poseduese ZK Prishtinë nr. 8296 me numër protokolli 2262/02 dt. 10.07.2002.
- Ndërtesa e drejtorisë afërsisht 5228 m<sup>2</sup>,
- Servisi i larjes së autobusëve me dy kanale afër 568 m<sup>2</sup> katrore (e dhënë me qira),
- Perona 21 me nr. rendor prej 1 deri 21 me mbishkrim të linjës. Ndërmarrja posedon edhe objekte përcjellëse si që janë: informata, dispiqeringu, biletarinë, shenjat e komunikacionit vertikal dhe horizontal, stazat dhe parkingu.

#### Aktivitet e ndërmarrjes janë:

- a) Pranimi dhe përcjellja e autobusëve,
- b) Pranimi dhe përcjellja e udhëtarëve,
- c) Shitja dhe rezervimi i biletave të autobusëve, për linjat urbane, urbane periferike, ndërurbane dhe ndërkombëtare,
- d) Informimi i udhëtarëve,
- e) Dhënia e shërbimeve turistike,
- f) Pranimi dhe ruajtja e bagazhit,
- g) Kontrolli i respektimit të rendit të udhëtimit,
- h) Shërbimet tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorët transportues,
- i) Shfrytëzimi i hapësirave të Stacionit (qiradhënie),
- j) Garazhimi dhe servisimi i autobusëve,
- k) Ndërmarrja mund të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, i cili lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të paraparë nga legjislati në fuqi.

Ndërmarrja ka llogarinë e vet bankare ne NLB Prishtina dhe një llogari ne ProCredit Bankë por, te gjitha transaksionet e firmës kryhen përmes llogarisë bankare ne NLB Prishtina.

Ndërmarrja sipas Ligjit dhe Statutit ka Bordin drejtuese të zgjedhur nga komuna e Prishtinës, (aksionari), Menaxhmentin dhe punëtorët që janë të dizajnuar në shemën organizative dhe me datë 31.01.2016 ka pasë 72 punëtorë, ndërsa me datë 31.12.2016 ka pasë te punësuar gjithsejtë 86 punëtor (me 31.12.2015 69 punëtorë), duke përfshirë ne listën e pagave edhe katër anëtarë të bordit te drejtorëve.

## **2. Bazat e përgatitjes dhe Politikat e kontabilitetit**

### **2.1 Përputhshmëria dhe baza e përgatitjes**

Këto pasqyrat financiare janë të përgatitura në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Interpretimet (ndryshe IFRS) të botuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) siç janë adaptuar nga Unioni Evropian ("IFRS të adaptuara").

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat matëse te specifikuara ne procedura për çdo lloj të asetëve, të detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë plotësisht të përshkruara në politikat e kontabilitetit më poshtë.

### **2.2 Parimi i vazhdueshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke u bazuar në parimin e vazhdueshmërisë.

### **2.3 Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet në fuqi nga 1 Janari 2016**

Një numër i standardeve të reja që janë lëshuar nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit, interpretime dhe amendamente të lëshuara nga Komiteti i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) kanë hyrë në fuqi për periudhën që fillon nga (ose pas) 1 Janar 2016. Shënim: jo të gjitha standardet dhe interpretimet e reja që kanë hyrë në fuqi për herë të parë për periudhën nga (ose pas) 1 Janar 2016 kanë efekt në pasqyrat financiare të kompanisë.

- **IFRS 14 "Rregullimi i llogarive te shtyra"** (hyn ne fuqi për periudhën raportuese qe fillon me apo pas 1 Janar 2016),
- **Amendamentimet ne IFRS 10 "Pasqyrat e Konsoliduara Financiare", IFRS 12 "Shpalosja e Interesit ne Entitete te tjera" and IAS 28 "Investimet ne Ortakëri dhe Sipërmarrje te Përbashkët"** - Entitetet Investuese: Aplikimi i përjashtimeve ne Konsolidim (hyn ne fuqi për periudhën vjetore qe fillon me apo pas 1Janar 2016),
- **Ndryshimet ne IFRS 11 "Marrëveshjet e Përbashkëta "** – Kontabiliteti për blerjen e interesit ne operacione te përbashkëta (hyn ne fuqi për periudhën vjetore qe fillon me apo pas 1 Janar 2016),
- **Ndryshimet ne IAS 1 "Prezantimi i Pasqyrave Financiare"** - Iniciativa për Shpalosje (hyn ne fuqi për periudhën vjetore qe fillon me apo pas 1 Janar 2016),
- **Ndryshimet ne IAS 16 "Prona, Toka dhe Pajisjet" dhe IAS 38 "Pasuritë e Paprekshme"** - Sqarime për Metodatat e Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit (hyn ne fuqi për periudhën vjetore qe fillon me apo pas 1 Janar 2016),
- **Ndryshimet ne IAS 16 "Prona, Toka dhe Pajisjet" dhe IAS 41 "Bujqësia"** - Bujqësia: Bimët prodhuese (hyn ne fuqi për periudhën vjetore qe fillon me apo pas 1 Janar 2016),
- **Ndryshimet ne IAS 27 "Pasqyrat e Veçanta Financiare"** - Metoda e Ekuitetit ne Pasqyrat e Veçanta Financiare (hyn ne fuqi për periudhën vjetore qe fillon me apo pas 1 Janar 2016),
- **Ndryshimet ne Standardet e Ndryshme "Përmirësimet ne IFRS (cikli 2012-2014)"** rrjedh nga projekti vjetor i përmirësimeve te IFRS (IFRS 5, IFRS 7, IAS 19 dhe IAS 34) kryesisht ne pikëpamje

te eliminimit te mospërputhjeve dhe sqarimit te formulimit (ndryshimet do te aplikohen për periudhën vjetore qe fillon me apo pas 1 Janar 2016).

Adaptimi i këtyre ndryshimeve ne standardet ekzistuese dhe interpretimet nuk ka ndikuar ne ndonjë ndryshim te pasqyrave financiare te Kompanisë.

## 2. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

### 2.4 Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet që janë efektive në periudhën pas vitit që mbaron me 31 Dhjetor 2016

Më poshtë është një listë e SNRF të ri dhe të rishikuar që nuk janë akoma detyrimisht në fuqi (por lejojnë aplikimin e hershme) për vitin që mbaron më 31 Dhjetor 2016:

- **IFRS 9 "Instrumentet Financiare"** (hyn ne fuqi ne periudhën vjetore qe fillon me apo pas 1 Janar 2018),
- **IFRS 15 "Te ardhurat nga Kontratat dhe Klientët"** dhe ndryshimet e mëtejshme (hyn ne fuqi ne periudhën vjetore qe fillon me apo pas 1 Janar 2018),
- **IFRS 16 "Qiratë"** (hyn ne fuqi ne periudhën vjetore qe fillon me apo pas 1 Janar 2019),
- **Ndryshimet ne IFRS 2 "Pagesat me baze Aksionin"** - Klasifikimi dhe Matja e Aksioneve-baza e Pagesës se transaksionit (hyn ne fuqi ne periudhën vjetore qe fillon me apo pas 1 Janar 2018),
- **Ndryshimet ne IFRS 10 "Pasqyrat e Konsoliduara Financiare " dhe IAS 28 "Investimet ne Ortakëri dhe Sipërmarrje te Përbashkët "** - Shitja apo Kontributi i Pasurisë ne mes te Investitorit dhe Ortakërisë apo Sipërmarrjes se Përbashkët dhe ndryshime te mëtejshme (data e hyrjes ne fuqi shtyhet ne një afat te pacaktuar derisa te projekti kërkimor për metodën e ekuitetit përfundon),
- **Ndryshimet ne IAS 7 "Pasqyra e rrjedhës se parasë"** - Iniciativat për shpalesje (hyn ne fuqi për periudhën vjetore qe fillon me apo pas 1 Janar 2017),
- **Ndryshimet ne IAS 12 "Tatimet mbi te ardhurat"** - Njohja e Pasurisë Tatimore te Shtyre për humbjet e porealizuara (hyn ne fuqi për periudhën vjetore qe fillon me apo pas 1 Janar 2017).

Kompania ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre ne fuqi. Kompania parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e zbatimit fillestar.

### 2.4 Valuta e prezantimit

Valuta prezantuese dhe raportuese e Kompanisë është Euro (EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Euro ishte adoptuar si valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej datës 1 Janar 2002.

Në vijim janë politikat themelore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar (SNFR). Pasqyrat financiare janë përgatitur nën marrëveshjen e kostos historike, ndërsa e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në shumat e rivlerësuar sikurse janë të përshkruara tutje në këto shënime.

Përgatitja e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF-të kërkon përdorimin e parashikimeve të shpeshta kritike të kontabilitetit. Gjithashtu kërkojnë nga menaxhmenti të ushtrojnë gjykimin e tyre në

proceset e aplikimit të politikave të kontabilitetit. Megjithatë këto parashikime janë bazuar në njohuritë dhe ngjarjet e tanishme dhe veprimet më të mira të menaxhmentit, rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të parashikuara.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur për vitin, deri me 31 dhjetor 2016. Të gjitha të dhënat janë të shprehura në mija Euro ( Euro) vetëm nëse është e cekur ndryshe.

## 2.5 Adoptimi i Standardeve të reja dhe të reviduara

Në vitin e tanishëm, Kompania ka adoptuar të gjitha Standardet e reja dhe të rishikuara dhe interpretimet e lëshuara nga Bordi i Standardeve Nderkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe të Komitetit Interpretues Nderkombëtar të Raportimit Financiar (KINRF) të (BSNK) të cilat janë relevante në aktivitetet e saj dhe efektive për periudhat raportuese vjetore. Adoptimi i Standardeve të reja dhe të reviduara dhe Interpretimet nuk kanë rezultuar në ndryshimet e politikave të kontabilitetit të Ndërmarrjes.

## 3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit

### 3.1 Aktivitet Afatgjatë (Toka, Ndërtesat dhe Pajisjet)

Zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve që ekzistojnë me 1 janar 2016 janë bartur sipas kostos së tyre historike, minus zhvlerësimi i akumuluar pasues Kosto paraqet shpenzimin që i atribuohet drejtpërdrejtë përvetësimit (blerjes) të zërave. Kostot pasuese janë përfshirë në vlerë bartëse të mjeteve apo është njohur si mjet i veçantë, në mënyrë të duhur, vetëm atëherë kur përfitimet ekonomike të mundshme lidhur me këtë mund të rrjedhin në Kompani dhe kostoja e mjetit mund të matet besueshëm. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Zhvlerësimi në pasuritë është bërë me metodën drejtvizore për të alokuar kostot e tyre ose shumat e rivilerësuara të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar, siç vijon:

Ndërtesat	5%
Pajisjet prodhuese dhe makineria,	10%
Kompjuterët, Pajisjet e zyrës, veturat	20%

Vlerat e mbetura të pasurive dhe jeta e përdorimit janë rishikuar, dhe rregulluar nëse është e nevojshme, në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera bartëse e një pasurie është e shënuar menjëherë në vlerën e saj të rikuperueshme nëse vlera bartëse e pasurisë është më e madhe se sa është parashikuar vlera e rikuperueshme.

Humbjet ose fitimi janë përcaktuar nga rrjedha e krahasimit me vlerën bartëse. Këto janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave.

### 3.2 Dëmtimet e aseteve jo-financiare

Pasuritë të cilat kanë jetë përdorimi të padefinuar nuk i janë nënshtruar zhvlerësimit dhe testohen çdo vit për dëmtimin në vlerë. Pasuritë të cilat i nënshtrohen zhvlerësimit janë rishikuar për dëmet kurdo që ndodhin ose në rrethanat të cilat e shtyjnë që vlera bartëse nuk mund të rikuperohet.

Humbjet nga dëmet janë njohur për vlerën të cilën e kalon vlerën e rikuperueshme të vlerës bartëse të pasurisë. Vlera e rikuperimit është vlera më e madhe në mes të vlerës së një pasurie në përdorim dhe vlerës fer të saj minus kosto e shitjes. Për qëllime të vlerësimit të dëmeve, pasuritë që nuk mund të testohen në mënyrë individuale janë grupuara në nivelin më të ultë të pasurive që gjenerojnë para nga përdorimi i vazhdueshëm i tyre e që janë të pavarura nga pasuritë tjera ose grupe të pasurive. Pasuritë jo-financiare të cilat janë dëmtuar janë rishikuar për mundësi pezullimi të dëmeve në secilën datë raportimi.

### 3.3 Asetet Financiare

Asetet Financiare klasifikohen në kategoritë e specifikuar vijuese: mjetet financiare në vlerën reale përmes fitimit apo humbjes, kreditë dhe të arkëtueshmet, mallrat e gatshme për shitje. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i mjeteve financiare që janë përvetësuar. Menaxhmenti e përcakton klasifikimin e mjeteve financiare në njohjen fillestare. Deri në datën e bilancit të gjendjes, Kompania nuk ka asete të klasifikuara në kategoritë e vlerës fer përmes Fitimit apo Humbjes aseteve të gatshme për shitje. Blerjet dhe shitjet e aseteve financiare njihen në datën e tregtimit- data kur Kompania zoton blerjen apo shitjen.

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë asetet financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktuara që nuk janë kuotuar në treg aktiv. Janë të përfshira në asetet qarkulluese, përveç atyre që maturohen pas 12 muaj pas datës së bilancit të gjendjes. Këto janë klasifikuar si pasuri jo-qarkullues. Kreditë dhe të arkëtueshmet e Kompanisë përbehen prej „të arkëtueshmeve tregtare dhe tjera“ dhe parasë dhe ekuivalenteve të parasë në bilancin e gjendjes.

### 3.4 Të arkëtueshmet tregtare dhe tjera

Të arkëtueshmet tregtare njihen në fillim në vlerën e tyre reale dhe më pas të matura më koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit, minus provizionin për dëmet. Provizionin për dëmet e të arkëtueshmeve tregtare është vendosur aty ku ka dëshmi të mjaftueshme që Kompania nuk do të jetë në gjendje t'i mbledh të gjitha shumat sipas kushteve origjinale.

Vështirësitë e mëdha të debitorit, me gjasë që debitori do të bankrotoj apo do të riorganizohet financiarisht, mos pagesa apo gabimi në pagesa (që vonohen më shumë se 30 ditë) konsiderohen si indikator që të arkëtueshmet tregtare janë dëmtuar. Shuma e provizionit është diferenca në mes vlerës bartëse të aseteve dhe vlera prezentë e vlerësuar e rrjedhjes së parasë në të ardhmen, e zbritur në normën origjinale efektive të interesit. Asetet me maturi afatshkurta nuk janë zbritur.

Vlera bartëse e mjeteve zvogëlohet përmes përdorimit të një kontoje për lejime, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave në „koston e shitjeve dhe të marketingut“. Kur një e arkëtueshme tregtare është e pambledhshme, shlyhet kundër kontos për lejimet e të arkëtueshmeve tregtare. Paraprakisht kthimi i shumave, të shlyera më parë kreditohen kundër „koston e shitjeve dhe të marketingut“ në pasqyrën e të ardhurave.

### 3.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë mbahen në bilancin e gjendjes sipas koston. Për qëllime të pasqyrës se rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

### 3.6 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përbehet nga vlera reale e monetare e evidentuar dhe kontribuar nga aksionaret e Kompanisë.

### 3.7 Beneficionet e të punësuarve

Kompania kontribuon për punëtorët e saj në planet pas pensionimit si janë të përshkruara nga legjislacioni për kontributet pensionale. Kontributet, bazuar në paga, bëhen në organizatën kombëtare përgjegjëse për pagesat e pensioneve. Nuk ka ndonjë detyrim shtesë lidhur me këto plane dhe këto skema konsiderohen si plan i caktuar i kontributeve.

Kompania nuk ka beneficione pas pensionimi për punëtorët e tyre.

### 3.8 Të pagueshmet tjera dhe tregtare

Të pagueshmet tjera dhe tregtare njihen në vlerën reale dhe më pas maten me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

### 3.9 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të hyrat njihen atëherë kur ekziston dëshmia bindëse, që zakonisht është në formë të marrëveshjeve për shitje, pasi që rreziqet dhe përfitimet domethënëse të pronësisë janë transferuar tek blerësi dhe kthimi i mundshëm i mallrave mund të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme. Të hyrat nga shërbimet njihen në pasqyrën e të ardhurave në proporcion me fazën e përfundimit (kompletimit) të transaksionit në datën e raportimit. Faza e kompletimit vlerësohet duke iu referuar ekzaminimit të punës së kryer. Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në kohën e pranimit të shërbimit ose në datën e origjinës.

### 3.10 Provizionet

Provizioni njihet kur Kompania ka një obligim të tanishëm si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe kompania ka një obligim aktual ose të parashikuar që mund të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme dhe është e mundshme të kërkohet rrjedh dalëse e përfitimeve ekonomike për të paguar obligimin. Provizionet janë rishikuar në çdo datë të bilancit të gjendjes dhe rregulluar për të reflektuar parashikimet me të mira të tanishme. Kur ndikimi i vlerës në kohë të parës është material, shuma e provizionit është vlera e tanishme e shpenzimeve të pritura që do kërkohen të vendoset obligimi.

### 3.11 Zotimet dhe kontigjencat

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato shpalosen vetëm nëse mundësia e rrjedhës së burimeve është e largët. Pasuria kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur ardhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjeve kontingjente njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë at detyrim i shfaqur në datën e bilancit të gjendjes dhe parashikimi i arsyeshëm i shumës së rezultuar të humbjes që mund të bëhet.

### 4. Gjikimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit të Kompanisë

Në aplikimin e politikave të kontabilitetit, të cilat janë të përshkruara në Shënimin 3, nga menaxhmenti kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumat e bartura të aseteve dhe detyrimeve të cilat nuk janë lehtësisht të qarta nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlydhura janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorët tjerë të cilët konsiderohen të jenë relevantë.

### 5. Burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen, dhe burimet tjera kryesore të pasigurisë në vlerësim në datën e bilancit të gjendjes, të cilat paraqesin një rrezik domethënës për të shkaktuar korrigjime materiale në vlerën e bartur të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit financiar vijues, janë diskutuar më poshtë:

Provizioni për llogaritë e arkëtueshme tregtare:

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësime për kthimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme. Duke u bazuar në këtë, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e kërkesave. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

Vlerësimi i rasteve ligjore:

Ne rrjedhen normale te biznesit, Kompania ben nje vlerësim per shumat qe nevojiten per shlyerjen e rasteve ligjore sipas udhezimit te keshilltarit ligjor te Kompanise. Ne baze te ketij vlerësimi, Kompania ne perputhje me kete regjistron provizionin nese ka, apo shpalos detyrimin kontingjent. Rezultatet aktuale mund te jene te ndryshme nga ato te vlerësuara

Vlerësimi për çeshtjet ambientale, çaktivizimin dhe çeshtjet tjera të nderlidhura, aktualisht nuk ka asnje kerkese detyruese ligjore per mjedisin, çaktivizimin dhe dispozitat tjera të lidhura ne Kosove

## 6. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

Kostoja	Toka €	Ndërtesat €	Pajisjet, mobilieritë, kompjuterët €	Puna në proces €	Gjithsej €
Më 1 janar 2015	1,158,868.60	6,861,331.82	166,578.97	-	8,186,779.39
Shtesat gjatë vitit	-	-	34,387.46	-	34,387.46
Transferet	-	-	-	-	-
Riklasifikimet	-	-	-	-	-
Shlyerjet	-	-	-	-	0
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>1,158,868.60</b>	<b>6,861,331.82</b>	<b>200,966.43</b>	<b>-</b>	<b>8,221,166.85</b>
Shtesat gjatë vitit 2016	-	14,797.33	22,647.71	-	37,445.04
Transferet	-	-	-	-	-
Riklasifikimet	-	-	-	-	-
Shlyerjet	-	-	-	-	0
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,158,868.60</b>	<b>6,876,129.15</b>	<b>223,614.14</b>	<b>-</b>	<b>8,258,611.89</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi</b>					
Më 1 janar 2015	0	5,012,459.82	159,918.95	-	5,172,378.77
Zhvlerësimi vjetor	0	166,330.33	5,480.09	-	171,810.42
Dëmtimi	0	0	0	0	-
Minus –zhvlerësimi i akumuluar në pasuritë e shlyera	0	0	0	0	-
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>0</b>	<b>5,178,790.15</b>	<b>165,399.04</b>	<b>-</b>	<b>5,344,189.19</b>
Zhvlerësimi vjetor 2016	0	166,515.31	6,196.55	-	172,711.86
Dëmtimi	0	0	0	0	-
Minus –zhvlerësimi i akumuluar në pasuritë e shlyera	0	0	0	0	-
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>0</b>	<b>5,345,305.46</b>	<b>171,595.59</b>	<b>-</b>	<b>5,516,901.05</b>
<b>Vlera neto</b>					
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,158,868.60</b>	<b>1,530,823.69</b>	<b>52,018.55</b>	<b>-</b>	<b>2,741,710.84</b>

Subjekti posedon parcelën prej 7 ha e 62 ari e 29 m<sup>2</sup>, dhe objektin ku zhvillon aktivitetet. Saldo e paraqitur në PF, rrjedhë si saldo e bartur nga librat prej periudhave të kaluara dhe është arritur nga një vlerësim i vitit 2000 dhe vlerat e investimeve kapitale gjatë periudhës prej vitit 2000 e deri më 31.12.2016. Vlerësimi i takon një vlerësimi të këtyre pronave vite më parë. Nga vlerësimi fillestar kuptohet se kjo pasuri ka nevojë për

një rivlerësim nga ekspertë përkatës pasi që vlerat e paraqitura në Pasqyrat financiare nuk e paraqesin vlerën e drejtë.

Gjatë testimit të objektivës së vlefshmërisë kemi konstatuar që kemi mbështetje të qëndrueshme të dokumentacionit që argumenton pohimet e menaxhmentit në pasqyra financiare për pajisjet. Në një selektim rigoroz të dokumentacionit dhe ekzistencës së pajisjeve mund të konkludojmë se pajisjet ekzistojnë.

\*\*\* Si praktikë e mirë të bëhet rivlerësimi i pasurisë sipas rregullores (KE) Nr. 1606 mbi aplikimin SNK-ëve, dhe në veçanti SNK-36, Vendimit Shpjegues Publik, MEF-ATK nr. 05/2009 (për Zhvlerësimin dhe dëmtimin e aseteve të Ndërmarrjeve me Pronësi Publike -NPP), Ligjit nr.03/L-139 (për shpronësimin e pronës së paluajtshme), Ligjit nr. 03/L-204 (për tatimin në pronën e paluajtshme), si dhe Udhëzimet Administrative të tyre.

## 7. STOQET

Stoqet ne pasqyrat financiare kompania i ka paraqit në vlerë prej 1,441.68 euro, ( në vitin 2015 kane qene ne vlere prej 1,561.57 euro).

	2016	2015
Lënda e parë dhe materiali	1,442	1,562
	<u>1,442</u>	<u>1,562</u>

Stoqet janë paraqitur me çmimin më të ulët ose në vlerën e realizueshme neto. Shpenzimet e shkaktuara gjatë vendosjes së secilit zë të stoqeve në vendin e tyre të tanishëm dhe konditat janë llogaritur për lëndë të parë dhe për të mira konsumuese si çmim i blerjes sipas metodës së vlerës mesatare.

Vlera e realizueshme neto është lartësi e çmimit të kalkuluar në shpenzimet e zakonshme të biznesit ,duke zbritur shpenzimet e kalkuluara të vlerës përfundimtare dhe shpenzimet e llogaritura të nevojshme për kryerjen e shitjes Provizionet përkatëse të bazuara në përlllogaritjet e drejtimit janë bërë për të reflektuar zbritjen e vlerës së stoqeve për shkak të vjetërsisë.

## 8. LLOGARIA E ARKËTUESHME DHE TË TJERA

	31.12.2016	31.12.2015
Ll/A nga klientët e operacional	52,165	139,346
Huadhënia për Sh.A."Plastika" Prishtinë	7,669	7,669
Huaja e dhënë Kosovatrans – Lipjan	767	767
Kërkesat nga punëtorët	1,518	2,110
Paradh.e tatimit në fitim	1,144	14,710
Paradhënie e tatimit në Qira	36,442	9,027
Bekos LTD	-	129
	<u>99,705</u>	<u>173,758</u>

Llogaritë e arkëtueshme te kompanisë kanë qenë në vlere bruto 146,945.08 euro, mirëpo për shkak se një vlerë prej 94,780.16€ të Llogarive të arkëtueshme janë bartur nga e kaluara dhe nuk i takonte periudhës së vitit 2016, me rekomandim Bordit të Drejtorëve u formua një komisioni i cili bëri verifikimin e borxheve të vjetruara dhe të dyshimta, rekomandon që të bëhet provizionimi (korigjimi) i borxheve të këqija për shkak të vjetërsisë apo të mos inkasimet të tyre edhe pse shumica prej tyre janë në procedura gjyqësore këto janë: Qamil Gashi 8,348.12€, Adem Zeka 3,070.88€, DPH Rehatia 3,918.93, NPTSH Skenderaj 1,104.09, Triumfi 453.57€, Krenaria 8,220.46€, Dardania 26,496.66€, Byrektorja 2,965.06€, Turist Kosova 34,530.43€, Kosova e Re 549.12€. 89,657.32€.

Po ashtu, disa nga borxhet kanë qenë të dyshimta dhe të vjetruara si dhe faturat ishin bërë pa marrëveshje të dy anshme etj., atëherë nuk kemi mundur t'i inkasojmë dhe si të tilla me rekomandim të Bordit të drejtorëve dhe të komisionit janë shlyer në tërësi të cilat janë: Kunevikët 380.00€, K.S Kosova 336.00€, PCB 52.25€, Festimi 443.96, Zhitija 500.00€, Fadili Tours 291.67€, Agon Uka 517.44€ SHPK, Victoria Tours 139.99€, Bleri 70.00€, Nexhi Tours 280.00€, NLB 86.94€, Dardani 333.50€, Meridian Corporation 16.00€, Bici Com1, 432.02€, Dardani PZ 280.00€, Albakos Mitrovicë 231.00€, Vëllezërit Thaçi 100.00€, Saba Tours 90.00€, dhe NTP World Sistem 542.07€, gjithsejtë 5,122.84€. Pas shlyerjeve dhe korigjimeve, saldo e llogarive të arkëtueshme është paraqitur në Bilancin e Gjendjes në vlerë prej 52,164 (146,945 – 89,657 – 5,123 = 52,164.92€).

Kërkesat nga kompanitë në falimentim janë: Plastika 7,669.94€; Kosovatrans Lipjan 766.94; kërkesat e tjera - ATK-ja 37,586.23€. Këto kërkesa pra, paraqesin kërkesat nga personat që shfrytëzojnë hapësirat e Stacionit të Autobusëve me qira, disa parapagime dhe të tjera.

Kompania ka bere shlyerjen ne emër te borjeve te këqija duke u bazuar ne Ligjin Nr. 03/L-162 Për Tatimin në të ardhurat e Korporatave nenit 12 Borxhet e këqija.

Po ashtu kemi përzgjedhë mostra për konfirmim të llogarive të arkëtueshme nga blerësit mirëpo deri në përpilimin e këtij Raporti nuk kemi marrë konfirmimet e pritura. Më procedura alternative jemi përpjekur të testojmë saktësinë e tepricave të paraqitura nga kompania.

Megjithatë mos konfirmimet nga blerësit krijojnë pasiguri për tepricat, për paraqitjen e drejtë dhe të saktë të Llogarive të arkëtueshme me date 31.12.2016.

9. PARAJA DHE EKUIVALENTET E PARASË	2016	2015
Paratë e gatshme në bankë dhe arkë	<u>243,536</u>	<u>197,932</u>
	<b>243,536</b>	<b>197,932</b>

Paraja e gatshme në fund të periudhës përbëhet nga pjesa e mbetur e parave që zotëron subjekti më 31.12.2016 në llogaritë bankare me te cilat bashkëpunon, në ProCredit Bankë dhe NLB Bankë Prishtina. Subjekti aplikon sistemin e hyrjeve të dyfishta në lidhje me të gjitha transaksionet ekonomike që ndodhin në periudhë. Subjekti bënë regjistrimin e transaksioneve bankare dhe bënë konsolidimet bankare me paranë e gatshme në fund të vitit. Paraja ne banke dhe arke me date 31.12.2015 është 197,932.38 euro.

#### 10. LLOGARITË E PAGUESHME dhe DETYRIMET TJERA

Të pagueshmet të tjera dhe tregëtare njihen në vlerën reale të tyre, dhe më pas maten me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

LLOGARITË E PAGUESHME dhe DETYRIMET TJERA	2016	2015
LI/P për klientët e Operacional	41,247	36,606
Avanset e marra/te hyrat e shtyra	7,880	7,926
LI/P për tatimet, TVSH (DHJETOR 2015)	9,780	11,256
Tatimi në të ardhura i pagueshëm	5,016	5,129
Kontributi 22personale nga punëtori i pagueshëm	3,600	3,503
Kontributi 22personale nga punëdhëdhënësi i pagueshëm	3,600	3,503
	<u>71,123</u>	<u>67,923</u>

Llogaritë e pagueshme në fund të periudhës 31.12.2016, janë paraqitur në Bilancin e gjendjes në vlerë prej 71,123.23 të cilat përfshijnë obligimet për llogaritë e rregullta tregtare në shumë prej 41,247.30€, për

Sindikaten e punetoreve si te pagueshme 521.95€, avanset e marrura nga viti 1999 ne shume prej 5,624.21€, dhe parapagime gjate vitit 1,734.10 €.

Ne obligime dhe tatime perfshihen TVSH-ja 9,780.31€, tatimi ne paga i pagueshem 5,015.99€, Kontributi nga punetoret i pagueshem 3,599.69€ dhe nga punedhenesi i pagueshem 3,599.69€.

## 11. TË HYRAT

Kompania realizon të hyrat nga tre aktivitete si me poshtë:

	2016	2015
Te Hyrat nga Peronizimet	541,796	525,664
Te Hyrat nga Qiraja	152,488	137,131
Te Hyrat nga Parkingu	15,847	8,193
Të hyrat nga shërbimi i Stacionit	12,098	14,325
Te hyrat nga provizioni i shitjes se biletave	22,366	34,489
Te hyrat nga shërbimet në portë	138,642	97,280
Te hyrat nga garderoba	1,301	1,054
Te hyrat nga qiraxhitë (rryma)	31,345	39,191
Të hyrat nga qiraxhitë (tjii)	3,716	29,756
Te hyrat nga qiraxhitë (mbeturinat)	3,791	3,372
Te hyrat e tjera	153	0
<b>Totali i të Hyrave</b>	<b>923,543</b>	<b>890,455</b>

Të hyrat nga peronizimet, janë te hyrat kryesore te kompanisë qe perfshijnë 58.66% te totalit te hyrave dhe njihen nga pagesat e peronit të stacionit të autobusëve konform UA NR.08/2013. Stacioni ka 170 kompani (138 ndërurban dhe 32 kompani qe operojnë jashte kufijve te Kosoves ndersa, 42 kompani operojnë ne relacionet urbano-periferike kryesisht ne relacionet e Llapit, Gollakut dhe Vushtrise me rreth 133 nise ditore por, nuk hyjnë ne stacionin e autobusëve.

Të hyrat nga qiraja paraqesin qiratë me aktivitetet biznesore qe zhvillohen në hapësirën e lokacionit te Stacionit, për afërsisht janë 22 operator.

Një pjesë e hapësirës së stacionit shfrytëzohet për parking me pagesë.

## 12. SHPENZIMET OPERATIVE

	2016	2015
Kosto e mallit te shitur	2,121	4,193
	<b>2,121</b>	<b>4,193</b>
<b>Shpenzimet e pagave bruto</b>	<b>2016</b>	<b>2015</b>
Pagat dhe mëditjet	667,356	621,617
Kontributi për sig.pens/Punëdhënës	33,409	31,079
	<b>700,766</b>	<b>652,696</b>

Kompania në emër të punetoreve bën llogaritjen e pensioneve dhe tatimeve në pagën bruto të punetoreve dhe i paguan ato në bazë të ligjeve lokale. Këto shpenzime paraqiten në pasqyrën e të ardhurave në periudhën e njëjtë së bashku me shpenzimet e të ardhurave.

Kompania nuk ka ndonjë skemë shtesë pensionale apo të pensionimit të punetoreve të saj, andaj edhe nuk ka obligime për pensione. Për më tepër, kompania nuk është e obliguar të siguroj benefite shtesë për punetoret e tanishëm apo të mëparshëm. Kompensimi i punetoreve bëhet konform ligjeve, rregulloreve,

udhezimeve administrative dhe praktikave te mira si kontrata e pergjithshme kolektive dhe anekset e saj etj. Bazuar ne keto ligje dhe udhezime kompania pos pagës baze u njeh e dhe mjetet shtese për ndërrimin e natës 30%, ditet e festave 50% shujtën e ngrohtë ne vlerë prej 3.00€ bruto për një ditë si dhe per punen e kaluar prej 0.5% per çdo vit te pervojës së punës.

Shpenzimet e pagave ne vitin 2016 ne krahasim me vitin paraprak janë rrite prej 48,070 euro. Në këtë rritje të shpenzimeve ka ndikuar pasi që gjatë kësaj periudhe është rrit numri i të punësuarve, edhe pse kompania nuk ka arrit te rris ndonjë aktivitet shtesë per rritjen e numrit te punëtorëve.

Shpenzimet e pagave ne totalin e shpenzimeve operative marrin pjesë me 85.14%, gje që kjo nuk paraqet praktikë të mirë derisa kompania afaron me humbje.

#### Amortizimi dhe zhvlerësimi

	2016	2015
Zhvlerësimi	172,712	171,810
	<b>172,712</b>	<b>171,810</b>

Sa i perket amortizimit dhe zhvlerësimit specifikohet që të njëjta janë kalkuluar në bazë të jetës së dobishme te aktiveve dhe shfrytezimit të tyre në gjatësinë e përdorimit.

#### Shpenzimet e tjera

	2016	2015
Shpenzimet Administrative	15,491	35,967
Shpenzimet e telefonit	7,933	7,472
Shpenzimet e rrymes	58,570	64,566
Shpenzimet e mirëmbajtjes	6,619	7,431
Provizionimi i borxheve te keqija	89,657	0
Shlyerje Direkte	5,123	
Shpenzimet e tjera operative	31,590	42,053
	<b>214,983</b>	<b>157,489</b>

#### 13. FITIMI (HUMBJA) PARA TATIMIT

	2016	2015
Fitimi para tatimit	-167,038	-122,513
	<b>-167,038</b>	<b>-122,513</b>

Fitimi / humbja para tatimit paraqet diferencën në mes të hyrave dhe shpenzimeve e cila pasqyron rezultatin e vitit afarist.

Pasi që kompania punon me vite radhazi me humbje dhe sipas legjislacionit ne fuqi humbja bartet deri ne gjashte vite, dhe nëse kompania vazhdon kështu me humbje mund të ve ne dyshim parimin e vazhdimësisë.

	2016	2015
Të hyrat	923,544	863,676
Shpenzimet	1,090,581	986,188
Humbja e periudhës / vitit	<b>(167,037)</b>	<b>(122,512)</b>

Tatimi në atë ardhura paraqet shumën e tatimit e cila është e pagueshme dhe tatimin e përlogaritur. Tatimi i cili llogaritet dhe paguhet në pajtim me Ligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Ligji Nr.05/L-

29. Tarifa për tatimi në fitim të korporatave është 10%, duke u bazuar në fitimin vjetor të rregulluar për njësitë, të cilat janë të matshme. Firma ka humbje të cilën e bartë duke u bazuar në legjislacionin vijues humbja mund të bartet për 6 (gjashtë) vitet e ardhshme nga momenti i paraqitjes së humbjes.

#### **14. Tatimet në të ardhurat e korporatave**

Rregullat e nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-162 Për tatimin mbi të ardhurat e Korporatave e rregullojnë materien për tatimet në të ardhura dhe përcaktojnë që shkalla e tatimit është 10%.

Po ashtu rregullat e nenit 28 të Ligjit 03/L-162 Për tatimin mbi të ardhurat e Korporatave potencojnë se: Tatimpaguesi rezident në Kosovë që përfiton të ardhura nga aktivitetet afariste jashtë Kosovës dhe i cili paguan tatimin në të ardhura në shtete tjera sipas këtij Ligji i lejohej një kredi tatimore për tatimin në të ardhura të paguar në shtetin tjetër që i atribuohet të ardhurave që krijohen në shtetin tjetër. Mandej sipas te njetit nen Kreditimi tatimor i lejuar në paragrafin 1 të këtij neni është i kufizuar në shumën e tatimit të jashtëm të paguar në të ardhurat e përfituara jashtë Kosovës, e nuk tejkalon shumën e tatimit obligues në Kosovë në ato të ardhurat. Për aq sa tatimi i Kosovës në ato të ardhura tejkalon tatimin e jashtëm të paguar, shuma tepricë duhet të përfshihet në llogaritjen e tatimit obligues të Kosovës.

Në harmoni me rregullat tatimore të aplikueshme në Republikën e Kosovës, kompanisë i kërkohet që deri me datë 31 Mars 2017 duhet të dorëzojë pranë autoriteteve tatimore Deklaratën mbi tatimin në të ardhurat e korporatave për vitin 2016.

Sipas pohimeve të drejtimit Autoritetet tatimore nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje për librat dhe shënimet e kompanisë për tatimet në të ardhurat e korporatave deri në kohën e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2016.

Tatimet shtesë ose ndëshkimet që mund të arkëtohen në rast të një auditimi tatimor, nuk mund të përcaktohen në këtë moment me ndonjë saktësi të arsyeshme.

#### **Instrumentet financiare**

Instrumentet financiare kryesore të ndërmarrjes, përveç borxhlinjve tregtarë dhe kreditorë tregtarë, rrjedhin nga operacionet e saja të zakonshme, duke përfshirë paranë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme.

#### **Vlera fer e instrumenteve financiare**

Instrumentet financiare të cilat janë të paraqitura në bilancin e gjendjes përfshijnë paratë e gatshme në arkë dhe në bankë, të arkëtueshmet dhe pagueshmet. Vlera bartëse e këtyre instrumenteve financiare është e përafërt me vlerën e tyre reale. Vlera reale-fer është ajo shumë e cila mund të ndërrohet në mes të dy palëve me vetëdije të plotë dhe me dëshirën e palëve me një transaksion në gjetësinë e krahut.

#### **Tatimi në të ardhura**

Tatimi në të ardhura paraqet shumën e tatimit e cila është e pagueshme dhe tatimin e përlogaritur. Tatimi i cili llogaritet dhe paguhet në pajtim me Ligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Ligji Nr.05/L-29. Tarifa për tatimi në fitim të korporatave është 10%, duke u bazuar në fitimin vjetor të rregulluar për njësitë, të cilat janë të matshme. Firma ka humbje të cilën e bartë duke u bazuar në legjislacionin vijues humbja mund të bartet për 6 (gjashtë) vitet e ardhshme nga momenti i paraqitjes së humbjes.

Po ashti ndërmarrja zbaton edhe : Ligji Nr.05/L-28 Për Tatimin në të Ardhura personale si dhe Ligji Nr.05/L-37 Tatimi në Vlerën e Shtuar.

## **Tatimi në qira**

Tatimi në qira prej 9% është llogaritur dhe është ndale në Burim nga ana e Ministrisë së Infrastrukturas dhe disa kompanive të tjera që njihen si persona Juridik. Dhe që nga 01.09.2015 edhe kompanitë e tjera të cilët janë në cilësinë e qiramarrjes e ndalin tatimin e qirase në burim dhe të njëjtit kanë për obligim që në fund të vitit ta dëshmojnë pagesën e tatimit në burim të qirase nëpër mes të certifikatës standard të përcaktuar nga ana e ATK-s. Kjo vlerë nuk është bërë kërkesë për rimbursim por është evidentuar si kërkesa ndaj ATK-es dhe kompania ka vendosur që në të ardhmen të shërben për shlyerjen e obligimeve vijuese ndaj ATK-es.

## **Risku financiar menaxhues**

Risku menaxhues i Kompanisë bartet nga Menaxhmenti. Risku i menaxhmentit është fokusuar në Paparashikueshmërinë e tregjeve dhe mundohet të minimizoj efektet e kundërta mbi performancën biznesore të Ndërmarrjes.

## **Risku kreditor**

Ndërmarrja nuk ka koncentrimë domethënëse të riskut kreditor. Ndërmarrja ka politikë të vendosura që shitja e të mirave dhe shërbimet u behen klientëve me një histori kreditore të pastër. Ndërmarrja ka politikë që e limitojnë shumën e ekspozuar kreditore të ndonjë kundër partneri. Maksimumi i ekspozimit të Ndërmarrjes ndaj riskut kreditor prezantohet nga shumat bartëse e secilit mjet financiar në bilancin e gjendjes.

## **Menaxhimi i riskut kapital**

Objektivat e Kompanisë kur menaxhojnë me kapital janë të ruajnë mundësinë që Kompania të vazhdojë sipas parimit të vijimësisë në mënyrë që të sigurojë kthime për aksionarët dhe përfitime për aksionarët tjerë dhe të mirëmbaj një strukturë optimale të kapitalit që të ulë koston e kapitalit. Në mënyrë që të mirëmbaj apo rregulloj strukturën e kapitalit, Kompania mund ta rrisë apo kthejë kapitalin të aksionarët apo shes pasuritë që ti ulë detyrimet.

## **Detyrimet tatimore**

Librat tatimor dhe regjistrimet e Kompanisë për vitin 2016 nuk janë inspektuar nga autoritetet tatimore të Kosovës. Detyrimet për tatimet e Kompanisë nuk mund të konsiderohen të përfunduara.

Që nga viti 2006 e deri më 31.12.2016 Ndërmarrja pos vizitave për ndonjë letër kujtese dhe kërkesave për pale të treta nuk ka pas ndonjë inspektim apo kontroll detale nga ana e ATK-s, prandaj nuk ka siguri se nëse behet ndonjë auditim tatimor se nuk mund të dalin obligime shtesë.

Tatimet shtesë që mund të dalin gjatë inspektimit nuk mund të vlerësohen me saktësi të arsyeshme

## **Ngjarjet pas datës së Bilancit**

Auditori nuk ka njohuri dhe Drejtimi i kompanisë nuk ka prezentuar ndonjë rast që mund të ketë ndikim në pasqyrat financiare të vitit 2016 deri në përpilimin e këtij raporti.

## **Parimi i vazhdimësisë**

Edhe pse kompania për vite ka afaruar me rezultate negative financiare, po ashtu në vitin 2016, kompania ka përmbyll vitin afarist humbje.

Mundësia e vazhimit të aktivitetit të ndërmarrjes edhe për 12 (dymbëdhjetë) muajt e ardhshëm, në bazë të mjeteve të disponueshme, projekteve aktive dhe planeve të menaxhmentit, nuk vihet në dyshim. Drejtimi pohon se, kompania ka burime të mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit.

#### **Njohja dhe vlerësimi i kontrollit të brendshëm dhe sistemit të kontabilitetit**

Kemi zgjedhur strategjinë e mosbesimit apo (testeve të pavarura) në kontrollin e brendshëm. Kemi bërë biseda me nivelin e duhur të Drejtimit, mbikëqyrësve dhe personelit tjetër, hulumtimin dhe verifikimin e dokumentacionit, raporteve dhe dosjeve elektronike. Vëzhgimi i aplikimeve të kontrolleve të veçanta të brendshme.

Gjatë procedurave audituese bazuar në atë që kemi arritë të shohim, mund të pohojmë se në kompani kontrollohen të gjitha raportet dhe dokumentet tjera financiare dhe se këto raporte janë të aprovuara nga Drejtimi i ndërmarrjes.

#### **Ne po ashtu jemi siguruar se:**

Zërat bilancor janë në harmoni me shumat e prezantuara dhe të regjistruara. Auditimi është kryer në pajtim me rregullat e kërkuara në instruksionet e auditimit lidhur me kryerjen e detyrave të auditimit, si dhe gjithë personeli i involvuar ka treguar kooperativitet të lartë.

#### **Sigurimi i dëshmive dhe testeve gjatë procesit të Auditimit**

Në N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. – Prishtinë, kemi kryer një sërë testesh përmes mostrave të dëshmive autentike. Punën e testimit dhe sigurimit të dëshmive kryesisht i kemi zhvilluar me ndihmën e personelit të entitetit ku do të prezantojmë disa prej dëshmive dhe mostrave të zgjedhura nga evidenca e librave të kontabilitetit dhe dokumentacionit tjetër që janë shfrytëzuar gjatë auditimit:

- Kontratat në mes të kompanisë dhe partnerëve afarist;
- Kontratat në mes të punësuarve të rregullt dhe ndërmarrjes;
- Evidencat kontabilitet të cilat kanë qenë lëndë e auditimit;
- Pasqyrat financiare dhe të aktiviteteve lidhur me ndërmarrjen;
- Pasqyrat e llogarive bankare;
- Librat e blerjes dhe Librat e shitjes për vitin 2016;
- Librin kryesor për vitin 2016;

Çdo dokument tjetër i cili ka të bëjë me auditimin e pasqyrave financiare.